



# EU4M BULETINI

QERSHOR 2023

## BE PËR BASHKITË, BE PËR KOMUNITETET VENDORE!

Përmirësimi i infrastrukturës dhe ngritja e kapaciteteve për shërbime më të mira dhe jetesë më të mirë.

Të dashur lexues,

Kemi kënaqësinë t'ju paraqesim buletinin e tretë të Projektit 'BE për Bashkitë' (EU4M), i financuar nga Bashkimi Evropian. EU4M synon nxitjen e potencialeve të zhvillimit të bashkivë, si dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike dhe mjedisore të komuniteteve vendore në Shqipëri.

Gjatë muajve të fundit, 'BE për Bashkitë' ka përfunduar fazën e kontraktimit për thirrjen e dytë për propozime, ku 13 bashki të tjera u mbështetën me grante deri në 50,000 EURO për ndërhyrje të vogla, për përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve vendore, për zhvillimin e të rinjve dhe të komunitetit, për edukimin, kujdesin social, kulturën dhe sportet në nivel vendor...

PUBLIKIMI NR. 3



## Kush jemi ne?

Skema e Granteve 'BE për Bashkitë' është një projekt pionier i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ku BE ofron një mundësi për asistencë për bashkitë për të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë vendore, jo vetëm për sektorë të veçantë.

Nëpërmjet dy thirrjeve për propozime të hapura për të gjitha bashkitë shqiptare, me anë të granteve të investimeve nga kjo skemë do të trajtohen fushat e infrastrukturës dhe shërbimeve publike vendore, zhvillimi ekonomik vendor, risitë, krijimi i vendeve të reja të punës, mbrojtja e mjedisit dhe fuqizimi i të rinjve.

Projekti zbatohet nga NALAS, Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore, në partneritet me partnerët lokalë: Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Eko-Partnerët për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Shoqata e Autonomisë Vendore.





Projekti 'BE për Bashkitë' po mbështet gjithsej 19 bashki, me një vlerë totale prej 1.9 milionë euro, duke i ndihmuar ato të zbatojnë planet dhe prioritetet e tyre strategjike në lidhje me modernizimin e infrastrukturës dhe shërbimeve vendore nga njëra anë si dhe ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e projekteve të BE-së në anën tjetër. Duhet përmendur fakti që për disa bashki është hera e parë që kanë fituar dhe do të menaxhojnë një projekt të financuar nga BE.

'BE për Bashkitë' mbetet një model i përpjekjeve të përbashkëta të BE, një sive të vetëqeverisjes vendore dhe shoqatave të tyre për t'u angazhuar me ritëm të shpejtë në rinovimin e infrastrukturës publike dhe sjelljen e standardeve të BE-së pranë qytetarëve, në mënyrë që ata të mund t'i përjetojnë ato në jetën e përditshme. Bashkitë në vendet e Bashkimit Evropian kanë luajtur rolin e motorit të modernizimit të shërbimeve publike dhe zhvillimit ekonomik në komunitetet vendore nëpërmjet përdorimit të mbështetjes financiare të BE-së. Kjo është një arsye përse kjo mbështetje nga BE është kaq shumë e nevojshme, veçanërisht në këtë moment në Shqipëri.

NALAS, Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore, si koordinatori i projektit, së bashku me Shoqatën për Autonomi Vendore dhe partnerët tanë Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe ECOPartners for Sustainable Development, janë shumë krenarë për zbatimin e këtij projekti të rëndësishëm për bashkitë në Shqipëri.

Në këtë buletin do të mësoni më shumë rreth aktiviteteve të projektit 'BE për Bashkitë', si dhe mbështetjes së BE-së për zhvillimin e komuniteteve vendore në Shqipëri nëpërmjet granteve të inve-

stiveve. Do të mësoni më shumë nga 2 prej 19 fituesve të granteve lidhur me rëndësinë e granteve për komunitetet vendore si dhe rreth kapaciteteve dhe sfidave me të cilat bashkitë në Shqipëri ende përballen për sa i përket hapjes së llogarivë bankare për projekte, pavarësisht përmirësimeve rregulatore të kohëve të fundit.

Gjatë 6 muajve të fundit, Projekti 'BE për Bashkitë' i ka ofruar mbështetje bashkive fituese të granteve që në hapat fillestarë të tyre për menaxhimin dhe zbatimin e granteve. Ai ka organizuar 9 trajnime lidhur me aspekte të ndryshme të menaxhimit të granteve, monitorimit dhe raportimit si dhe katër klinika trajnuese. Këto aktivitete kanë lehtësuar të mësuarit ndërmjet kolegëve (peer-to-peer) si dhe ndarjen e njohurive rreth problemeve të hasura dhe zgjidhjet e evidentuara gjatë zbatimit. Po ashtu, kemi kontribuar në ngritjen e kapaciteteve për 116 punonjës të bashkive të angazhuar në procesin e zbatimit.

Ndërkohë që projekti do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për bashkitë partnere, është e qartë që janë të nevojshme përmirësime të mëtejshme të procedurave për hapjen e llogarive bankare, sipas praktikave të suksesshme nga rajoni.

Po kaq e rëndësishme është edhe fakti që do të mësoni më shumë në lidhje me 19 projektet e suksesshme të cilat po mbështeten nga 'BE për Bashkitë' dhe se cili është ndikimi i pritshëm i tyre te komunitetet vendore.

Lexim të mbarë!

*Elton Stafa  
Drejtues i Ekipit të Projektit "BE për Bashkitë"  
Drejtor i NALAS në Shqipëri*

## Integrimi i Shqipërisë në BE, drejt një historie vendore suksesi

Me organizimin e Konferencës së parë Ndërqeveritare mbi negociatat e anëtarësimit, që u mbajt në korrik 2022, **Shqipëria hapi një fazë të re drejt hyrjes së saj në BE.** Kjo është një arritje shumë e rëndësishme. BE dhe Shqipëria u angazhuan menjëherë në të ashtuquajturin “screening (vlerësim)”, proces intensiv që synon evidentimin e nivelit aktual të adaptimit në Shqipëri të legjislacionit të BE-së (“acquis”). Ajo që është më e rëndësishme, vlerësojmë se **70% e legjislacionit të BE-së po zbatohet aktualisht në nivel rajonal ose vendor.** Për Shqipërinë, kjo nënkupton që bashkitë do të luajnë një rol edhe më vendimtar dhe do të



duhet të jenë plotësisht të përfshira në procesin e integrimit në BE.

**Për këtë arsye, do të ishte i rëndësishëm zhvillimi i një dialogu rreth integrimit në BE në nivel vendor dhe me përfshirjen e komuniteteve.** Qeveria shqiptare duhet të tregojë një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse, jo vetëm duke i angazhuar autoritetet vendore në ato çështje që kanë ndikim tek ta, por duke përfshirë në këtë dialog edhe grupet e tjera të interesit, si organizatat vendore të shoqërisë civile, përfaqësuesit e biznesit dhe grupet rinore. Kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiake luajnë një rol thelbësor në nxitjen dhe mbështetjen e këtij dialogu.

**Shqipëria duhet të bëjë hapa përpara edhe në përpjekjet e saj për të ngritur në nivel vendor ekspertizën dhe kapacitetet që lidhen me BE-në.** Duhet nxjerrë mësim nga përvojat e vendeve të tjera që janë bërë anëtare të BE-së këto vitet e fundit, ku qeverisjet vendore nuk ishin fillimisht në gjendje të përfitonin plotësisht nga mbështetja financiare e BE, për shkak të mungesës së kapaciteteve. Duhet t'i përgatisim autoritetet vendore dhe organizatat e shoqërisë civile që të jenë në gjendje të menaxhojnë më shumë burime financiare, të cilat do të vijnë pas anëtarësimit në BE, me synim përmirësimin e jetës së përditshme të qytetarëve. Në këto rrethana, BE ka treguar një vëmendje gjithnjë e më të madhe ndaj bashkive në Shqipëri, përfshirë



**Christiane Hohmann**  
Ambasadore e Delegacionit të BE-së në Shqipëri

këtu edhe nëpërmjet asistencës së drejtpërdrejt. Gjatë këtyre viteve, BE e ka mbështetur Shqipërinë praktikisht në të gjitha aspektet e strategjisë së saj të decentralizimit. Ne kemi investuar në zhvillimin **institucional dhe të kapaciteteve**, nëpërmjet konsolidimit të njësive të BE-së në nivel bashkiak. Kemi mbështetur **ofrimin e shërbimeve publike**, nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve njerëzore dhe me krijimin e zyrave të shërbimeve vendore me një ndalesë. Po ashtu, kemi nxitur një **dialog më efikas dhe efektiv ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore**, nëpërmjet mbështetjes së Këshillit Konsultativ. Së fundmi, me programet e mbështetjes së buxhetit, kemi inkurajuar **decentralizimin fiskal dhe harmonizimin ligjor.**

Në Shqipëri, mbështetja financiare e BE-së ndaj qeverisjes dhe komuniteteve vendore është rritur jo vetëm në aspektin e volumit të financimit, me programe mbështetëse që aktualisht shkojnë në 34 milionë euro, por kemi zgjeruar edhe fushën e veprimtarisë. Përveç mbështetjes sektoriale, që nga viti 2021, nëpërmjet programit **“BE për Bashkitë”, BE po mbështet 19 bashki me grante direkte, vlera e të cilave arrin në 1.7 milion EURO,** duke mundësuar realizimin e prioritetëve të tyre vendore. Këto grante, të administruara plotësisht nga vetë bashkitë, kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, nxisin zhvillimin ekonomik, inovacionin, krijimin e vendeve të reja të punës, mbrojtjen e mjedisit dhe fuqizimin e të rinjve. “Evropa është këtu” në çdo qytet dhe fshat ku jetojnë shqiptarët.

**Por, në fund të fundit, ndryshimi i vërtetë do të vijë nga vetë Shqipëria.** Siç theksohet në raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022, bashkitë kanë nevojë të pajisen me burimet e duhura në mënyrë që ato të mund t'i plotësojnë me sukses misionet e tyre, përfshirë këtu edhe zbatimin e rregullave dhe të rregulloreve të BE-së. Ky përbën një investim afatgjatë për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit si pjesë e BE-së.

*Christiane Hohmann*  
Ambasadore e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri

## Zhvillimi social kalon nëpërmjet shërbimeve vendore

Një qendër multifunktionale, një çerdhe dhe një kopsht do të rivitalizohen sipas standardeve bashkëkohore në Bashkinë e Shkodrës. Qëllimi kryesor i këtij investimi të financuar nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet projektit 'BE për Bashkitë'

është përmirësimi i shërbimeve për komunitetin në një zonë të pazhvilluar dhe informale të kryeqendrës së veriut. Kryetari i Bashkisë së Shkodrës, z. Bardh Spahia tregon rëndësinë që ka një mbështetje e tillë.



Kryetar i Bashkisë Shkodër, z. Bardh Spahia (i dyti në të majtë)

### Çfarë do të thotë për bashkinë tuaj fitorja e grantit nga Projekti "BE për Bashkitë"?

Bashkia Shkodër nënshkroi kontratën e grantit më 23 qershor të vitit të kaluar dhe ishte copëza që i mungonte një investimi madhor të planifikuar në një ndër zonat me më shumë nevoja të qytetit. Nga një shkollë e braktisur, brenda pak muajve do të jemi të gatshëm të ofrojmë një qendër multifunktionale me standarde shumë të mira dhe me një shumëllojshmëri shërbimesh, ku dua të vë theksin tek kopshti dhe çerdhja e parë me drekë në zonë për të cilën ka patur kërkesa të vazhdueshme nga komuniteti. Në këtë qendër është menduar që qeliza bazë e shoqërisë, familja, të marrë shërbime që nga fëmija e deri tek të moshuarit, të cilët do të kenë një qendër ditore për të kaluar pak kohë cilësore.

Projekti "BE për Bashkitë" ka vlerësimin maksimal për vetë faktin që ndihmon drejtpërsëdrejti bashkitë në përmirësimin e infrastrukturës për shërbime publike, aq më tepër duke patur

parasysh buxhetin që disponojnë bashkitë dhe nevojat e shumta në territor. Uroj që me suksesin e këtij projekti t'i hapim rrugë bashkëpunimeve të ardhshme.



*Nëpërmjet grantit nga 'BE për Bashkitë', Bashkia Shkodër do të finalizojë investimin e nisur për qendrën multifunktionale dhe rreth 500 anëtarë të komunitetit do të përfitojnë shërbimet sociale komunitare, ndërkohë që 150 fëmijë do të mund të përfitojnë nga kopshti dhe çerdhja e parë me drekë në zonë.*



**Përse nëpërmjet këtij granti Bashkia e Shkodrës ka targetuar komunitetin që jeton në zonat informale si përfituesit kryesorë?**

Bashkia Shkodër ka në fokus pa asnjë lloj diferencimi të gjithë qytetarët e saj dhe vizioni i saj është mbulimi sa më i gjerë i territorit me shërbime. Komuniteti i targetuar ka populluar zonën periferike të qytetit, rreth liqenit, pas viteve '90 duke formuar një lagje pothuajse të re, e cila ndër vite vetëm është zgjeruar dhe ka shfaqur nevoja për shërbime që nga ato më baziket.

Vetë titulli i projektit "Nxitja e përfshirjes sociale dhe zhvillimi i komunitetit" është arsyeja e targetimit të një komuniteti vulnerabël, me raste të shumta problematikash që nga dhuna në familje, marrëdhënia prind-fëmijë, të rinj në konflikt me ligjin, të moshuar të vetmuar apo nëna që nuk punojnë. Një qendër e tillë adreson të gjithë këta faktorë, që në një mënyrë apo tjetër

ndikojnë në shëndetin e të gjithë shoqërisë sonë.

**Kur mendoni se përfundon rehabilitimi i Qendrës Komunitare Multifunkionale dhe kur mendoni se kjo qendër do të jetë funksionale për komunitetin?**

Rehabilitimi i qendrës ka fillura në muajin prill dhe pritet të përfundojë në muajin gusht të këtij viti, për t'u përruar me praninë e Projektit 'BE për Bashkitë', donatorëve dhe Delegacionit të BE-së. Qendra do të jetë funksionale për shërbime ndaj të moshuarve, të rinjve dhe si qendër shëndetësore që me inagurimin e saj. Ndërsa kopshti dhe çerdhja kanë nevojë për pak më shumë kohë, dhe mendohet që të hapen në shtator të këtij viti.

## Fëmijët e Patosit me një qendër të re artistike e kulturore

Bashkia Patos është një nga bashkitë fituese të granteve në thirrjen e dytë të Projektit "BE për Bashkitë". Projekti fitues parashikon krijimin e infrastrukturës dhe shërbimeve cilësore për "Qendrën Kulturore të Fëmijëve". Përveç rikonstruksionit të godinës, qendra do të pajiset me instrumente muzikorë, si dhe do të rritet numri i kurseve dhe shërbimeve në disiplina të ndryshme.

Kryetarja e Bashkisë së Patosit, znj. Rajmonda Balilaj, tregon rëndësinë e fitores së këtij projekti, që financohet nga Bashkimi Evropian dhe që ka për qëllim të mbështesë potencialin zhvillimor të bashkive e të përmirësojë kushtet socio-ekonomike dhe mjedisore të komuniteteve në vend.

**Çfarë do të thotë për një bashki të vogël si e juaja fitorja e një granti nga Projekti "BE për Bashkitë"?**

Aksesi në grante për bashkitë e vogla është përgjithësisht më i ulët, sidomos kur aplikojnë edhe bashkitë e mëdha. Kjo vjen si pasojë e mungesës së përvojës dhe kapaciteteve. Megjithatë, falë asistencave teknike kemi arritur të sigurojmë disa kapacitete të qëndrueshme.

Bashkia Patos ka aplikuar në të dy skemat e granteve "BE për Bashkitë", por vetëm në thirrjen e dytë rezultoi fituese. Për ne nuk është vetëm fitore e një investimi, e cila ka absolutisht rëndësi dhe jemi mirënjohës Bashkimit Evropian për mbështetjen. Për ne është edhe sfida, e cila na



vendos para përgjegjësisë që zbatimi të jetë sa më korrekt dhe partneriteti me BE-në të jetë i qëndrueshëm.



*Me mbështetjen e Projektit 'BE për Bashkitë' 500 fëmijë të Patosit do të mund të përfitojnë nga infrastruktura dhe shërbime më të mira, 5 pajisje të reja muzikore dhe vegla më të vogla, ndërkohë që do të organizohen edhe 15 aktivitete kulturore gjatë kohëzgjatjes së projektit dhe jo vetëm.*

**Përse Bashkia e Patosit ka targetuar fëmijët si përfituesit kryesorë të shërbimeve të përmirësuara të bashkisë nëpërmjet këtij granti?**

Bashkia Patos ka parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor disa projekte prioritare. Si një bashki që njihet për tregues pozitiv të demokracisë vendore, projekt-idetë kalojnë në disa procese konsultimi. Qendra Kulturore e Fëmijëve është pjesë integrale e Pallatit të Kulturës, për të cilin nuk kemi arritur të gjejmë dritë financimi, për shkak të vlerës së lartë të projektit. Në këto kushte, nisur dhe nga numri i lartë i

fëmijëve që frekuentojnë qendrën kulturore, me kërkesë të prindërve, mësuesëve të disiplinave të ndryshme, kërkesës së fëmijëve për të shtuar disiplina, lindi nevoja që të ndërhyjmë në këtë qendër.

Patosi njihet për traditën e aktiviteteve kulturore dhe kjo do të shërbejë jo vetëm si një investim infrastrukturor, por edhe si një mundësi e shkëlqyer për të nxitur talentet e reja të qytetit. Ne po punojmë paralelisht për t'i shtuar programet artistike, ndaj ky investim vjen si një përgjigje e nevojave që komuniteti i vogëlushëve të talentuar premtan.

**Kur fillon rehabilitimi i Qendrës Kulturore dhe kur mendoni që do të fillojë punën?**



Për Bashkinë Patos është shumë e rëndësishme që gjatë fazës së zbatimit të zhvillojmë një proces sikurse kërkohet nga praktikatat e BE-së, në mënyrë që të rrisim kapacitetet tona në këtë fushë. E rëndësishme është që të ecim sipas udhëzimeve e afateve të përcaktuara në kontratë, ndaj sapo të mbyllet pjesa e dokumentacionit do të nisim me zbatimin teknik.

Jemi siguruar që veprimtaria e qendrës kulturore të vazhdojë. Ndaj u kemi siguruar fëmijëve ambiente në Pallatin e Kulturës. Synojmë që me fillimin e vitit të ri arsimor të hapim dyert e qendrës së rikonstruktuar për fëmijët e talentuar të qytetit, jo vetëm me kushte bashkëkohore, por të pasuruar edhe me instrumente të tjera artistike.

## BASHKIA PATOS

**1** Rehabilitimi i Qendrës së Kreativitetit të Fëmijëve në shërbim të **500** fëmijëve.

**2** **15** aktivitete të organizuara për Javën Evropiane 2023 me pjesëmarrjen e **77** fëmijëve.





Numri i përfituesve vendorë të granteve të EU4M

36,798

Numri i stafit të bashkive të trajnuar për shërbimet e reja vendore

273



Numri i ndërhyrjeve në infrastrukturë

23

Numri i shërbimeve vendore të reja apo të përmirësuara

79





# Asistencë për fuqizimin e kapaciteteve për

**19 bashkitë fituese**  
të skemës së granteve "BE Për Bashkitë".


**4** klinika mentoruese  
me pjesëmarrjen e

**40** punonjësve  
të bashkive



**9** trajnime rajonale për menaxhimin  
dhe zbatimin e granteve me

**108** punonjës  
të bashkive.



# Forcimi i kapaciteteve të bashkive shqiptare

gjatë zbatimit të Skemës së Granteve të

## “BE për Bashkitë”



**Trajnimi rajonal 1:** Shkodër 8-10 mars 2022 me 14 përfaqësues të bashkive nga veriu i Shqipërisë.



**Trajnimi rajonal 2:** Vlorë 15-17 mars 2022 me 20 përfaqësues të bashkive nga Shqipëria Jugore.



**Trajnimi rajonal 3:** Lezhë 28-29 prill 2022, me 16 përfaqësues të 10 bashkive nga Shqipëria Veriore.



**Trajnimi rajonal 4:** Elbasan 11-12 maj 2022, me 13 punonjës nga 8 bashki të Shqipërisë Qendrore e Jugore.



**Trajnimi rajonal 5:** Vlorë 16-17 maj 2022 me 29 përfaqësues nga 16 bashki të rajonit jugor të vendit.



**Trajnimi rajonal 6:** Tiranë 25-26 korrik me 19 përfaqësues të 6 bashkive fituese nga Thirrja 1 u fokusua te “Menaxhimi dhe zbatimi i granteve të BE për Bashkitë”.



**Trajnimi rajonal 7:** Tiranë 26 shtator 2022 me 14 përfaqësues të 6 bashkive fituese nga Thirrja 1 me temë “Monitorimi dhe raportimi i granteve të ‘BE për Bashkitë’”.



**Trajnimi rajonal 8:** Lushnje 13-14 tetor 2022 me 11 përfaqësuesve të 5 bashkive fituese nga Thirrja 2 me temë “Menaxhimi dhe zbatimi i granteve të BE për Bashkitë”.



**Trajnimi rajonal 9:** Tiranë 26-27 tetor 2022 me 12 përfaqësuesve nga 4 bashki (Tirana, Kavaja, Kamza dhe Klos) me temë “Menaxhimi dhe zbatimi i granteve të BE për Bashkitë”.



**Trajnimi rajonal 10:** Lezhë 7-8 nëntor 2022 me 13 përfaqësuesve nga 4 bashki (Lezha, Mirdita, Fushë-Arrëz dhe Tropoja) me temë “Menaxhimi dhe zbatimi i granteve të BE për Bashkitë”.



**Trajnimi rajonal 11:** Lushnje 25 janar 2023 me 11 punonjës të 6 bashkive (Lushnje, Skrapar, Rrogzhinë Kuçovë, Patos,) nga Thirrja 1 me temë “Monitorimi dhe raportimi i granteve të BE për Bashkitë”.



**Trajnimi rajonal 12:** Zoom 31 janar 2023 me 7 punonjës të 6 bashkive (Mat, Shkodër, Berat, Gjiro-kastër, Pukë, Përmet) nga Thirrja 1 me temë “Menaxhimi dhe zbatimi i granteve të BE për Bashkitë”.



**Trajnimi rajonal 13:** Lezhë 2 shkurt 2023 me 7 punonjës të 4 bashkive fituese (Lezhë, Mirditë, Fushë-Arrëz dhe Tropojë) me temë “Monitorimi dhe raportimi i granteve të BE për Bashkitë”.



**Trajnimi rajonal 14:** Tiranë 14 shkurt 2023 me 14 punonjës të 4 bashkive fituese (Tirana, Kavaja, Kamza dhe Klosi) me temë “Monitorimi dhe raportimi i granteve të BE për Bashkitë”.

## E ardhmja është e shkëlqyer, nëse ti investon për të!

Për të përfituar nga asistencë e BE-së, bashkitë në Shqipëri duhet të fuqizojnë si kapacitetet e tyre për thithjen e financimeve nga BE, ashtu dhe ato menaxhuese. Përvoja nga bashkitë nga vendet anëtare të NALAS-it në rajon por që janë edhe anëtarë të BE-së (Bullgaria, Kroacia, Rumania dhe Sllovenia) na mëson që edhe pas antarësimit në BE nevojiten vite për të ngritur kapacitetet e njësive të vetëqeverisjes vendore (NJQV) për menaxhimin e financimeve nga BE.

Për këtë arsye, bashkitë në Shqipëri duhet të vazhdojnë të investojnë në zhvillimin e kapaciteteve të tyre për menaxhimin e asistencës financiare të BE-së. BE i ka ndihmuar këto procese në Shqipëri me mbështetjen ndaj zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore dhe Projektit "Bashkitë për Evropën" dhe STAR3 të financuar nga BE.

Shoqatat e qeverisjes vendore (ShQV) luajnë një rol themelor dhe të pazëvendësueshëm në këtë drejtim. Kur projektet e asistencës teknike të kenë përfunduar, ShQV mund të sigurojnë vazhdimësinë e zhvillimit të kapaciteteve të NJQV-ve. Nga ky këndvështrim, ekziston një hapësirë e rëndësishme për përmirësim për sa i përket partneritetit ndërmjet delegacioneve të BE-së në rajon dhe këtyre shoqatave.

Në kuadrin e Projektit "BE për Bashkitë" në Shqipëri dhe në partneritet me Shoqatën për Autonomi Vendore në Shqipëri, NALAS ka nisur një proces të shkëmbimeve rajonale për ndarjen e praktikave të mira nga anëtarët e saj në lidhje me përgatitjet dhe kontributin e bashkive në procesin e integritimit evropian dhe, në të njëjtën kohë, rreth instrumenteve në mbështetje të përmirësimit të aftësive të thithjes së financimeve dhe kapaciteteve të menaxhimit të njësive të vetëqeverisjes vendore. ■

### Ngritja e kapaciteteve me mbështetjen e BE-së

Bashkimi Evropian po i mbështet gjithnjë e më shumë bashkitë në Shqipëri, duke qenë se ato janë më pranë nevojave të qytetarëve, por edhe në kontekstin e procesit të integritimit evropian, ku ato luajnë një rol themelor, me më shumë se 70% të Acquis Communautaire (tërësisë së të drejtave, detyrimeve dhe objektivave të BE-së), i cili zbatohet në nivel vendor. Sot BE i mbështet në fakt të katër shtyllat e strategjisë së decentralizimit. Krahas asistencës teknike, në mënyrë specifike në shtyllën e zhvillimit social-

ekonomik, BE ka krijuar një mbështetje konkrete nëpërmjet instrumentit të granteve.

Projekti 'BE për Bashkitë' synon nxitjen e potencialeve zhvillimore të bashkive dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike dhe mjedisore të komuniteteve vendore në Shqipëri. Projekti ka dy komponentë kryesore:

**1** Mbështetjen e bashkive për zbatimin e objektivave dhe planeve të tyre strategjike të zhvillimit.

**2** Mbështetjen e bashkive në ngritjen e kapaciteteve për përthithjen e financimeve nga BE, si dhe kapaciteteve për menaxhimin.

Nëpërmjet dy thirrjeve për propozime të hapura për të gjitha bashkitë shqiptare, grantet e 'BE për Bashkitë' mbulojnë fushat e infrastrukturës dhe shërbimeve publike vendore, zhvillimin ekonomik vendor, risitë, krijimin e vendeve të reja të punës, mbrojtjen e mjedisit dhe fuqizimin e të rinjve. Të gjitha këto dimensione janë thelbësore për të ardhmen e shqiptarëve dhe të procesit të integritimit në BE. Projekti ofron dy lloje grantesh me vlera që variojnë nga 50,000 dhe deri në 200,000 euro. Në total nga këto grante përfitojnë rreth një e treta e bashkive në vend. ■

----

Skema e Granteve 'BE për Bashkitë' është një projekt pionier i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, ku BE ofron një mundësi për asistencë ndaj bashkive për të gjithë spektrin e funksioneve dhe përgjegjësi vendore, jo thjesht ndaj sektorëve të veçantë. E thënë thjeshtë, skema është një instrument financiar që përdoret në të gjitha sektorët ku përfshihet qeverisja vendore, duke filluar nga arsimi, kujdesi social, mbrojtja e mjedisit, zhvillimi ekonomik vendor, të rinjtë, kultura, sportet, etj.

Qasja e gjerë sektoriale u bën të mundur bashkitë në Shqipëri që të përfitojnë nga mbështetja e BE-së nëpërmjet financimeve të para-aderimit, në të njëjtën mënyrë siç përfitojnë nga fondet strukturore të BE-së, bashkitë në vendet anëtare të BE-së. Kjo bën të mundur që qytetarët shqiptarë të fillojnë tashmë të ndajnë faktin që standardet e BE-së po vijnë në komunitetet e tyre, edhe përpara antarësimit, gjë e cila do të krijonte mundësi më të mira jetese në komunitetet tona.

Për NALAS-in, 'BE për Bashkitë' është model i përpjekjeve të përbashkëta të BE-së dhe shoqatave të qeverisjes vendore për t'u

angazhuar me ritëm të shpejtë në rinovimin e infrastrukturës publike dhe sjelljen e standardeve të BE-së pranë qytetarëve, në mënyrë që ata të mund t'i përjetojnë ato në jetën e përditshme. Bashkitë në vendet e Bashkimit Evropian kanë luajtur rolin e motorit për të modernizuar ofrimin

e shërbimeve publike dhe promovuar rritjen ekonomike vendore në komunitetet e tyre, nëpërmjet përdorimit të mbështetjes financiare të BE-së. Kjo është arsyeja se përse kjo mbështetje nga BE është kaq shumë e nevojshme, veçanërisht në këtë moment në Shqipëri. ■

## 'BE për Bashkitë' mbështet 19 bashki të tjera në Shqipëri me grante për investime

Ofrimi i shërbimeve cilësore për qytetarët përbën një sfidë dhe një prioritet për bashkitë në Shqipëri. Eficienca dhe zhvillimi i bashkive merr një peshë akoma më të madhe, për arsye se numri i funksioneve të bashkive në marrëdhënie me qytetarët është rritur, ndërkohë që edhe presioni për fuqizimin e institucioneve është shtuar më shumë me hapjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.



*Në këtë kuadër dhe në vazhdim të asistencës së ofruar qeverisjes vendore, "BE për Bashkitë" u ka akorduar 19 bashkive grante me vlerë totale 1.7 milionë euro, për modernizimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike në fushat e edukimit, shërbimeve sociale, kulturës dhe sporteve në nivel vendor, për të promovuar zhvillimin e qëndrueshem ekonomik vendor, duke përfshirë përdorimin me efikasitet të burimeve në nivel vendor.*



Gjashtë bashki shqiptare përfituan 1.1 milionë euro grante investimesh gjatë thirrjes së parë për propozime të projektit EU4M, duke mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërtimin, rijetësimin dhe rinovimin e mbi 11 objekteve arsimore, sociale, kulturore dhe tregtare në bashkitë Mat, Berat, Shkodër, Gjirokastër, Pukë, dhe Përmet, ku përfituesit kryesorë janë të rinjtë, gratë dhe kategoritë e marginalizuara. Projektet fituese u prezantuan gjatë ceremonisë së parë për nënshkrimin e kontratave të granteve, të organizuar në Bashkinë Mat, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Delegacionit të BE-së në Shqipëri, kryetarëve të bashkive dhe partnerëve të Projektit "BE për Bashkitë".

Në kuadrin e thirrjes së dytë për propozime, 13 bashki të tjera u mbështetën me grante me vlerë deri në 50.000 euro, për ndërhyrje të vogla për

përmirësimin e shërbimeve publike vendore në fushat e fuqizimit të të rinjve, edukimit, kulturës dhe sporteve në nivelin vendor. Projektet fituese u prezantuan gjatë ceremonisë së dytë për nënshkrimin e kontratave të granteve, organizuar në Bashkinë Lushnjë, me pjesëmarrjen e Ambasadores së BE-së në Shqipëri, Shkëlqesisë së Saj Znj. Christiane Hohmann, kolegëve të saj nga Delegacioni i BE, si dhe kryetarëve të bashkive nga bashkitë fituese dhe përfaqësuesve të qeverisë qendrore.

Ambasadorja e Delegacionit të BE-së në Tiranë, Christiane Hohmann, i nixti kryetarët e bashkive të pranishëm në ceremoni që të flisnin për komunitetin, duke theksuar edhe një herë funksionin kritik të qeverisjes vendore në lidhje me anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian. **"Përgëzime për 13 projektet fituese nga ana e programit "EU4Municipalities". Zbatimi i legjisllacionit të BE-së në Shqipëri, në vlerën afërsisht prej 70%, realizohet në nivelin lokal. Për këtë arsye unë sot në Lushnjë, i ri-theksoj kryetarëve të 13 bashkive fituese, rolin parësor të tyre në anëtarësimin në BE",** u shpreh në këtë ceremoni Ambasadorja e BE-së Christiane Hohmann.





Bashkitë Lushnjë, Skrapar, Patos, Kuçovë, Kamëz, Klos, Kavajë, Tropojë, Rrogozhinë, Mirditë, Tiranë, Lezhë, and Fushë-Arrëz, janë përfitueset e granteve, me shumën e përgjithshme prej 600,000 euro.

Kryetarja e Bashkisë Lushnjë, si mikpritëse e ceremonisë si dhe si kryetare e një prej bashkive përfituese të grantit nga thirrja e dytë, Znj. Eriselda Sefa, tha se kjo mbështetje përbën një mundësi fantastike për përmirësimin e nivelit të jetesës në komunitet.

**“Fokusi i institucionit që drejtoj është krijimi i një bashkie, e cila komunikon drejtëpërdrejt me komunitetin. Për këtë arsye, është me rëndësi të veçantë për mbajtja e infrastrukturës që do të ndërtojmë gjatë projektit, edhe pas përfundimit të tij.”**



Integrimi i vërtetë në BE, sipas Zëvendësministrit të Brendshëm, Z. Andi Mahila, ka të bëjë me standardet vendore që vihen në praktikë. **“Projekti “BE për Bashkitë” përbën një gur themeli për kapacitetet për përthithjen e granteve nga bashkitë. Bashkitë duhet t’i rrisin kapacitetet e tyre për menaxhimin e këtyre granteve dhe qeveria i ka mbështetur ato nëpërmjet përmirësimit të politikave të decentralizimit”,** sipas Zëvendësministrit Mahila.



Z. Enea Hoti, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, u shpreh se Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë po bashkëpunojnë ngushtë për zgjidhjen e problematikave që lidhen me administrimin e fondeve nga bashkitë përfituese.

**“Prej fillimit të zbatimit të reformës territoriale, aktualisht, çdo bashki është duke zbatuar të paktën një projekt. Ne jemi duke negociuar dhe kemi marrë një premtim që këto fonde do të rriten në të ardhmen”,** tha Z. Hoti.

Zëvendës drejtuesja e ekipit të projektit, Znj. Entela Pinguli, prezantoi 13 projektet fituese në kuadrin e thirrjes së dytë për propozime.

Debati i hapur lidhur me objektivat e zhvillimit vendor me kryetarët dhe zyrtarët e bashkive, u drejtua nga Znj. Adelina Farrici, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Lokale. Projekti "BE për Bashkitë" synon të rrisë kapacitetet në nivel bashkie, duke përmirësuar në të njëjtën kohë edhe kushtet socio-ekonomike të komuniteteve vendore në Shqipëri.

Për këtë arsye, bashkitë fituese të thirrjes së dytë do të kenë të njëjtat mundësi ashtu si edhe ato të thirrjes së parë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike dhe për të patur një rritje ekonomike të qëndrueshme vendore. Projekti "BE për Bashkitë" vë gjithashtu një theks të fuqishëm tek promovimi i të rinjve, kulturës dhe sporteve në komunitetet vendore.



# Çlirimi i Potencialit të Rinisë së Bashkisë Lushnjë



15

## BASHKIA LUSHNJË

### Informacion i Përgjithshëm

**Kohëzgjatja e Projektit: 8 muaj**  
**Buxheti i Përgjithshëm: 50,423 EUR**  
**Kontributi i BE-së: 45,380 EUR**  
**Kontributi Kombëtar: 5,043 EUR**  
**Komponenti i Investimeve: 32,000 EUR**

### Objektivi i Përgjithshëm

**Përmirësimi i shërbimeve bashkiake të cilat kontribuojnë në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të rinisë në Bashkinë Lushnjë.**

### Objektivat Specifike

**Infrastruktura publike dhe shërbimet të ri-vitalizuara në mbështetje dhe fuqizim të rinisë së Bashkisë Lushnjë.**

## Aktivitetet Kryesore

- 1.** Krijimi i një qendre rinore: Rregullimi i një ndërtese ekzistuese e cila do të transformohet në një qendër rinore multi-funksionale.
- 2.** Funksionimi i një qendre rinore nëpërmjet: Krijimit dhe funksionimit të katër klubeve rinore; Organizimi i tre kurseve edukative për mbështetjen e talenteve rinore; Organizimi i të paktën 16 aktiviteteve “nga të rinjtë, për të rinjtë”; Organizimi i ekspozitës për riciklimin.
- 3.** Aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit: përgatitja e një videoje promovuese, dizenjimi i materialeve promovuese, inagurimi i Qendrës Rinore dhe aktiviteti përfundimtar i projektit.







Funded by  
the European Union

**EU4MUNICIPALITIES**

## Rezultatet Kryesore

1. Një Qëndër Rinore multifunksionale e krijuar në Bashkinë Lushnje, që ofron 6 shërbime publike ndaj të paktën 230 të rinjve.
2. Ndërgjegjësim më i rritur i të rinjve rreth vlerave të BE-së në lidhje me mbrojtjen e mjedisit si dhe pjesëmarrja aktive e të paktën 60 të rinjve në 16 aktivitete kulturore dhe sportive.





# Ndërtimi i mjediseve sportive në shkollën “Zylyftar Veleshnja”

17



## BASHKIA SKRAPAR

### Informacion i Përgjithshëm

**Kohëzgjatja e Projektit: 9 muaj**  
**Buxheti i Përgjithshëm: 55,550 EUR**  
**Kontributi i BE-së: 50,000 EUR**  
**Kontributi Kombëtar: 5,550 EUR**  
**Komponenti i Investimeve: 39,000 EUR**

### Objektivi i Përgjithshëm

Përmirësimi i aftësive dhe shërbimeve për përfshirjen e nxënësve dhe të rinjve në aktivitete fizike dhe sportive, për një jetë më të shëndetshme në Bashkinë Skrapar.

### Objektivat Specifike

Ambiente sportive dhe aktivitete që angazhojnë të rinjtë e shkollës “Zylyftar Veleshnja” dhe lagjes “Estref Caka”.

## Aktivitetet Kryesore

1. Ndërtimi i një mjedisi sportiv në shkollën “Zylyftar Veleshnja” në Skrapar.
2. Krijimi i një akademie sportive në shkollën “Zylyftar Veleshnja” me qëllim promovimin e sportit të basketbollit në këtë shkollë si dhe në lagjen “Estref Caka”.
3. Hapja e qendrës komunitare në shkollën “Zylyftar Veleshnja”. Ndërtimi i mjediseve sportive- i një fushe basketbolli- në shkollën 9-vjeçare “Zylyftar Veleshnja”.
4. Organizimi i 2 aktiviteteve sportive për të rinjtë e lagjes “Estref Caka” për të promovuar përfitimet e ushtrimit të sporteve.



Funded by  
the European Union

**EU MUNICIPALITIES**

## Rezultatet Kryesore

1. Një mjedis i ri modern sportiv në shkollën “Zylyftar Veleshnja” për t’u përdorur nga 725 të rinj të me përfshirë dhe më të edukuar rreth përfitimeve nga ushtrimi i sporteve.
2. Një qëndër e qëndrueshme komunitare e krijuar dhe funksionale në shkollën “Zylyftar Veleshnja”, në shërbim të 120 antareve të komunitetit të lagjes “Estref Caka”.
3. Një akademi sportive e krijuar dhe operative në shkollën “Zylyftar Veleshnja” e cila mbështet 30 talente të reja me aftësimin në sportin e basketbollit dhe në promovimin, zhvillimin dhe diversifikimin e aktiviteteve sportive.



Para



Pas



# Përirësimi i kulturës dhe shërbimeve që lidhen me fëmijët



## BASHKIA PATOS

### Informacion i Përgjithshëm

**Kohëzgjatja e Projektit: 9 muaj**  
**Buxheti i Përgjithshëm: 54,657.27 EUR**  
**Kontributi i BE-së: 49,191.54 EUR**  
**Kontributi Kombëtar: 5,465.73 EUR**  
**Komponenti i Investimeve: 38,258.81 EUR**

### Objektivi i Përgjithshëm

Të kontribuojë për përmirësimin e zhvillimit të fëmijëve nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës lokale publike, cilësisë dhe aksesit tek shërbimet lokale për fëmijët, ofruar nga Bashkia Patos.

### Objektivat Specifike

Mundësi të shtuara për fëmijët e Bashkisë Patos, në mbështetje të kreativitetit, talentit dhe përfshirjes sociale, nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të Qendrës së Kreativitetit të Fëmijëve (QKF).

## Aktivitetet Kryesore

1. Rehabilitimi i hapësirës së QKF, në ndërtesën ekzistuese të Pallatit të Kulturës së Bashkisë Patos.
2. Mobilimi dhe pajisja e qendrës me instrumenta muzikore, pajisje për pikturë dhe vallëzim, si dhe me një sistem të ri audiofonik.
3. Aktiviteti inauguroes për hapjen e QKF.
4. Organizimi i 10 aktiviteteve në QKF: 5 aktivitete në kuadrin e javës së BE-së 2023, të cilat do të promovojnë integrimin evropian dhe vlerat evropiane, me fokusin tek fëmijët dhe njohuritë e tyre rreth BE-së.
5. Komunikimi dhe Vizibiliteti.
6. Inaugurimi i Qendrës së Kreativitetit të Fëmijëve.





Funded by  
the European Union

**EU4MUNICIPALITIES**

## Rezultatet Kryesore

1. Qendra e Kreativitetit të Fëmijëve (QKF) e rehabilituar dhe në shërbim të 500 fëmijëve nga Bashkia Patos.
2. QKF operative dhe funksionale me 5 lloje pajisjesh artistike (piano, violinë, kitarë, fizarmonike dhe organo) si dhe e furnizuar me pajisje të vogla në shërbim të fëmijëve.
3. 15 aktivitete kulturore dhe të rritjes së ndërgjegjësimit, të organizuara në kuadrin e Javës Evropiane 2023 me pjesëmarrjen e 77 fëmijëve.



# Rikonstruksioni i shkollës “Koço Korçari” Kuçovë



**BASHKIA KUÇOVË**

## Informacion i Përgjithshëm

**Kohëzgjatja e Projektit: 9 muaj**  
**Buxheti i Përgjithshëm: 49,725 EUR**  
**Kontributi i BE-së: 34,825 EUR**  
**Kontributi Kombëtar: 14,900 EUR**  
**Komponenti i Investimeve: 31,775 EUR**

## Objektivi i Përgjithshëm

Shërbime të përmirësuara vendore në fushën e arsimit në Bashkinë Kuçovë.

## Objektivat Specifike

Kushte të përmirësuara për arsim në shkollën “Koço Korçari”, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve të mësimdhënies për nxënësit.

## Aktivitetet Kryesore

1. Rikonstruksioni i dy ndërtesave shkollore si dhe i sistemeve elektrike dhe hidraulike të shkollës “Koço Korçari”.
2. Organizimi i inaugurimit të projektit.
3. Organizimi i 5 aktiviteteve edukative:
  - “Trashëgimia Kulturore e BE-së”, aktivitete edukative për Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë, që konsistojnë në një paradë folklorike tradicionale dhe një koncert, me pjesëmarrjen e 108 nxënësve dhe 12 mësuesve të shkollës “Koço Korçari”.
  - “Java festive e qytetit”, e cila përfshin rreth 12 lojëra krijuese të fëmijëve/të rinjve, të cila nxjerrin në pah influencën e kulturave evropiane në zhvillimin e Bashkisë Kuçovë.



Funded by  
the European Union

**EU4MUNICIPALITIES**

- “Aktiviteti i Ditës së Rinisë”, me 20 instrumentistë të rinj të cilët do të luajnë pjesë klasike dhe moderne nga kompozitorë të ndryshëm.
- Një ekspozitë e arteve vizive realizuar nga fëmijët, me pjesëmarrjen e 40 fëmijëve, duke përfshirë 10 fëmijë me aftësi ndryshe, të cilët do të shprehin kuptimin e tyre rreth vlerave të BE-së.
- Një anketim i menaxhuar nga 10 të rinj nga Bashkia Kuçovë dhe ndarja me publikun e rezultateve të tij, lidhur me performancën e bashkisë në lidhje me integrimin evropian.

## Rezultatet Kryesore

1. Infrastruktura e rehabilituar në shkollën “Koço Korçari” në Kuçovë (i sistemeve elektrike dhe hidraulike), duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies për 108 studentë.
2. 5 aktivitete kulturore dhe edukative, të cilat sjellin së bashku 300 fëmijë dhe 150 të rinj nga Bashkia Kuçovë, duke promovuar talentet, diversitetin dhe kreativitetin e tyre, si dhe duke i bërë më aktivë në kuptimin dhe ndarjen e vlerave të BE-së.



Para



Pas





3. Instalimi i koshave për ndarjen e diferencuar të mbetjeve dhe organizimi i aksioneve praktike të edukimit për komunitetet e shkollave rreth vlerave të BE-së për mjedisin e pastër dhe të gjelbër në 25 shkolla të Bashkisë Kamëz.
4. Organizimi i 25 aksioneve të gjelbërimit për çdo shkollë. Mbjellja e 10 pemëve dhe luleve në oborret e secilës shkollë.
5. Organizimi nga nxënësit i 25 muraleve me piktura në muret e oborreve të shkollave.

### Rezultatet Kryesore

1. Situata e menaxhimit të mbetjeve e përmirësuar në 25 shkolla, si dhe komunikimi dhe marrëveshjet e realizuara me kompanitë e riciklimit.
2. Rreth 20,000 studentë dhe anëtarë të komunitetit, më të informuar rreth ndarjes së mbetjeve, riciklimit dhe opsioneve të ripërdorimit.
3. 25 grupe ekologjike të krijuara dhe aktive në aktivitetet e shkollave të gjelbërta, me pjesëmarrjen aktive të 625 nxënësve.
3. Kopshte të gjelbërta shtesë të krijuara përreth 25 shkollave lokale të Bashkisë Kamëz.





# Hapat e parë: Mbështetje për mjedisin, pjesëmarrjen dhe sportin në Bashkinë Klos.



## BASHKIA KLOS

### Informacion i Përgjithshëm

**Kohëzgjatja e Projektit: 8 muaj**  
**Buxheti i Përgjithshëm: 53,392 EUR**  
**Kontributi i BE-së: 47,260 EUR**  
**Kontributi Kombëtar: 6,132 EUR**  
**Komponenti i Investimeve: 35,000 EUR**

### Objektivi i Përgjithshëm

**Përmirësimi i shërbimeve vendore dhe pjesëmarrjes së komunitetit lokal në zhvillimin e mirëqënies sociale në Bashkinë Klos.**

### Objektivat Specifike

**Zhvillimi përfshirës lokal, nëpërmjet përdorimit të formave të reja të përfshirjes së komunitetit nëpërmjet aktiviteteve të shëndetshme gjatë kohës së lirë dhe menaxhimit të të mirave të përbashkëta të këndit vendor të lojërave.**

## Aktivitetet Kryesore

- 1.** Krijimi i këndit të ri komunitar të lojërave
- 2.** Pajisja e këndit të lojërave dhe instalimi i masave të sigurisë për fëmijët e vegjël.
- 3.** Organizimi i 7 aktiviteteve edukative dhe për rritjen e kapaciteteve; 2 trajnime rreth aktiviteteve në mjedis të hapur për edukatorët e kopshtit; 2 trajnime rreth vlerave të BE-së për mbrojtjen e mjedisit dhe zvogëlimin e mbetjeve; një workshop me fëmijët për menaxhimin e diferencuar të mbetjeve.
- 4.** Organizimi i 7 aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit: 1 ditë pa plastikë; në festival me të gjitha shkollat për të inauguruar këndin e lojërave; 4 ditë ekologjike; një workshop për sportet.



Funded by  
the European Union

**EU4MUNICIPALITIES**

## Rezultatet Kryesore

1. Bashkia Klos pasurohet me një mjedis të gjelbër të hapur, për 390 fëmijë, prindër dhe gjyshër. Komunitet i ndërgjegjësuar në lidhje me impaktin pozitiv të një mjedisi të sigurtë për takime sociale.
2. 390 fëmijët e kopshteve lokale mund të përdorin një kënd lojërash të gjelbër dhe të sigurtë në ambient të hapur, gjatë orëve të mësimt.
3. Jeta kulturore dhe sportive në Bashkinë Klos pasurohet me 3 aktivitete të reja në mjedis të hapur.
4. Më shumë së 200 punonjës të bashkisë dhe 390 fëmijë të Bashkisë Klos, të ndërgjegjësuar dhe të informuar lidhur me vlerat e BE-së për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve.





# Promovimi i praktikave dhe instrumenteve inovative për reduktimin e emetimeve të karbonit dhe për të përmirësuar efikasitetin e energjisë në Bashkinë Kavajë.

## BASHKIA KAVAJË

### Informacion i Përgjithshëm

**Kohëzgjatja e Projektit: 9 muaj**  
**Buxheti i Përgjithshëm: 49, 770 EUR**  
**Kontributi i BE-së: 41, 400 EUR**  
**Kontributi Kombëtar: 8, 370 EUR**  
**Komponenti i Investimeve: 30, 000 EUR**

### Objektivi i Përgjithshëm

Përmirësimi i shërbimeve bashkiake të cilat kontribuojnë në zhvillimin dhe aplikimin e agjendës së gjelbër, me përfshirjen e komuniteteve lokale në Bashkinë Kavajë.

### Objektivat Specifike

Emetimet e karbonit në nivelin lokal të reduktuara në Bashkinë Kavajë, nëpërmjet "investimeve të shpejta" në shkollën e mesme të agro-biznesit në Golem, me përfshirjen e komuniteteve lokale në aktivitetet e energjisë së gjelbër dhe të ruajtjes së klimës.

## Aktivitetet Kryesore

1. Zhvillimi i Planit të Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme dhe Klimën (SECAP) për Bashkinë Kavajë.
2. Instalimi i një sistemi panelesh diellore me kapacitet total prej 26 kwp në tarracën e shkollës së bujqësisë.
3. Organizimi i 5 aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve rreth përdorimit të energjive të rinovueshme me pjesëmarrjen e përgjithshme të stafit të bashkisë dhe 20 studentëve nga shkolla e agro-biznesit, mbi energjinë e rinovueshme, ujitjen "e zgjuar" dhe menaxhimin e ujërave.




Funded by  
the European Union

**EU4MUNICIPALITIES**

4. Organizimi i 2 eventeve për transferimin e njohurive nga nxënësit e shkollës, me ndihmën e një mentori, tek të rinjtë tjerë rurale (fermerë), për aplikimin e sistemeve të energjisë së rinovueshme në fermat e tyre. Një seminar 5-ditor me përfaqësues nga hotelet e interesuara bregdetare, me tematikë krijimin e sistemit të menaxhimit të energjisë. Një manual në mbështetje të hoteleve bregdetare mbi reduktimin e konsumit të energjisë elektrike, kryesisht gjatë sezonit veror.
5. Organizimi i aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit: Dita e Energjisë në Bashkinë Kavajë, e cila do të promovojë vlerat e BE-së lidhur me eficientësinë energjitike.
6. Komunikimi dhe vizibiliteti: shpërndarja e 300 materialeve promovuese për të gjitha aktivitetet e sipërpërmendura.

### Rezultatet Kryesore

1. Sistemi i paneleve diellore (26 kwp) i instaluar në tarracën e shkollës së agro-biznesit "Charles Telford Erickson" në Golem, që ndihmon në uljen e konsumit të energjisë me 90%.
2. Përgatitja e Planit të Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme dhe Klimën për Bashkinë Kavajë 2022-2030, dhe prezantimi në Këshillin Bashkiak.
3. Kapacitetet të rritura të 5 autoriteteve përfaqësuese bashkiake lokale; 20 studentë, 5 përfaqësues nga hotelet dhe 10 fermerë të rinj, të informuar dhe përfshirë në praktikën e kursimit të energjisë, si dhe lidhur me praktikën e BE-së për eficientësinë energjitike.





# Të rinjtë aktive në Bashkinë e Tropojës (ATY4M)

## BASHKIA TROPOJË

### Informacion i Përgjithshëm

**Kohëzgjatja e Projektit: 8 muaj**

**Buxheti i Përgjithshëm: 53,848 EUR**

**Kontributi i BE-së: 48,463.2 EUR**

**Kontributi i Bashkisë: 4,000 EUR**

**Komponenti i Investimeve: 27,000 EUR**

### Objektivi i Përgjithshëm

**Aftësitë dhe shërbimet e përmirësuara në Bashkinë Tropojë, për ri-vitalizimin e jetës së të rinjve në bashkinë e tyre.**

### Objektivat Specifike

**Të rinjtë e Bashkisë Tropojë më të angazhuar dhe më të fuqizuar për të luajtur rolin e tyre në politikën, planet dhe projektet lokale si dhe në proceset vendim-marrëse nëpërmjet funksionimit të duhur të Këshillit Rinor dhe të qendrës së tyre rinore.**

## Aktivitetet Kryesore

- 1. Takimi fillestar me grupet e interesit dhe perfituesit.**
- 2. Rindërtimi i Qendrës Rinore me Bashkinë Tropojë.**
- 3. Përgatitja dhe krijimi i Këshillit Rinor dhe Planit të Punës për Rininë (YoWP).**
- 4. Aktivitete për rritjen e kapaciteteve për Qendrën Rinore: trajnim 3 (tre) ditor me përfaqësues nga sektori i rinisë në Bashkinë Tropojë dhe të rinj; sesione informuese për nxënës të trajnuar në shkollat e mesme rreth çështjeve të pjesëmarrjes së të rinjve në strukturat vendimmarrëse dhe rreth rolit të tyre në komunitet; përdorimi i metodave stimuluese nëpërmjet shembujve të mirë nga Bashkimi Evropian, të cilat do t'i prezantohen audiencës rinore, me qëllimin për të**



Funded by  
the European Union


**EU4MUNICIPALITIES**

stimuluar ndërgjegjen e tyre dhe vlerën e tyre për shoqërinë; një seminar 5-ditor do të organizohet me përfaqësues të Këshillit Rinor të Tropojës në një kamp rinor; trajnim 3-ditor i modelit “peer to peer”, me module të posaçme trajnimi rreth procesit të vendimmarrjes.

5. Komunikimi dhe vizibiliteti i Qendrës Rinore. Dizenjimi, printimi dhe shpërndarja e materialeve promovuese. Organizimi i Ditës Kombëtare të Rinisë në bashki, me praninë e shumë përfaqësuesve nga palët e interesuara.

### Rezultatet Kryesore

1. Qendra Rinore në Tropojë, e krijuar në ndërtesën e rikonstruktuar, siguron mbështetje operative për 3 iniciativa rinore (1 debat me pjesëmarrjen e 16 të rinjve, 1 iniciativë e klubeve sportive me pjesëmarrjen e 15 të rinjve, dhe krijimin e 10 grupeve vullnetare), me qëllim përmirësimin e kuptimit të tyre lidhur me integrimin evropian.
2. Këshilli Rinor i krijuar dhe funksional me një plan pune operativ për 5 vitet në vijim dhe me një staf të Qendrës Rinore të aftësuar për të menaxhuar programin e Këshillit Rinor në bashkëpunim me Bashkinë Tropojë.
3. 10 persona nga stafi i Bashkisë Tropojë, të aftësuar dhe në gjendje të menaxhojnë programin rinor si dhe të bashkëpunojnë me Këshillin Rinor.



# Fuqizimi i Udheheqesve te Ardhshem

## BASHKIA RROGOZHINË



### Informacion i Përgjithshëm

**Kohezgjatja e Projektit: 8 muaj**  
**Buxheti i Pergjithshem: 54,500.00 EUR**  
**Kontributi i BE-se: 49,050.00 EUR**  
**Kontributi Kombetar: 5,450.00 EUR**  
**Komponenti i Investimeve: 34,000.00 EUR**

### Objektivi i Përgjithshëm

**Përmirësimi i shërbimeve dhe kapaciteteve bashkiake për të kontribuar në mirëqënien e të rinjve në Bashkinë Rrogozhinë**

### Objektivat Specifike

**“Aftësi të buta” (të formimit të përgjithshëm) të përmirësuara (p.sh. aftësitë në komunikim, lidership, të menduarit kritik, etj), si dhe përfshirje më e lartë e të rinjve në jetën politike lokale dhe procesin e vendimmarrjes në nivel lokal, nëpërmjet rikonstruksionit dhe funksionimit të Qendrës Rinore**

### Aktivitetet Kryesore

- 1.** Prezantimi i projektit me palët e interesuara.
- 2.** Rikonstruksioni dhe mobilimi i Qendrës Rinore.
- 3.** Inaugurimi i Qendrës Rinore.
- 4.** Organizimi i aktiviteteve edukuese për rritjen e kapaciteteve në Qendrën Rinore: 6 sesione informuese. Përgatitja e manualit të trajnimit për aftësitë e komunikimit, lidershipin, të menduarit kritik dhe organizimi i 13 trajnimeve me pjesëmarrjen e 30 studentëve dhe 2 personave nga stafi i bashkisë.



- 5.** Organizimi i takimit të 30 studentëve me Këshillin Bashkiak, lidhur me çështjet që shqetësojnë komunitetin lokal, duke përdorur të gjitha aftësitë e përfituara nga trajnimet.

### Rezultatet Kryesore

- 1.** Ndërtesa e re e Qendrës Rinore në Bashkinë Rrogozhinë e rinovuar dhe mobiluar plotësisht, për t'i shërbyer 180 të rinjve.
- 2.** Pjesëmarrje e rritur e të rinjve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. 180 nxënës dhe 200 qytetarë të informuar mbi funksionimin e autoriteteve publike, me mekanizmat për përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe procesin e integritimit në BE.
- 3.** Aftësi të përmirësuara të stafit të bashkisë dhe 4 anëtarëve të stafit akademik (nga 2 për çdo shkollë), për ofrimin tek të rinjtë e moduleve inovative të trajnimit lidhur me aftësitë në komunikim, leadership, të menduarit kritik, etj.
- 4.** 30 nxënës të trajnuar në “aftësitë e buta” (të formimit të përgjithshëm) si për shembull: aftësitë në komunikim, leadership dhe të menduarit kritik, etj, të cilët marrin pjesë aktivisht në procesin e vendimmarrjes me Këshillin Bashkiak.





# BE për fëmijët në Rrëshen



## BASHKIA MIRDITË

### Informacion i Përgjithshëm

Kohëzgjatja e Projektit: 7 muaj  
Buxheti i Përgjithshëm: 46,856.99 EUR  
Kontributi i BE-se: 40,120.75 EUR  
Kontributi Kombëtar: 6,736.24 EUR  
Komponenti i Investimeve: 27,000 EUR

### Objektivi i Përgjithshëm

Ofrimi i shërbimeve publike të përmirësuara për komunitetin nëpërmjet ndërhyrjeve të vogla në qytetin e Rrëshenit

### Objektivat Specifike

Hapësira publike e përmirësuar në qytetin e Rrëshenit, si rezultat i rritjes së aksesueshmërisë për 1315 fëmijë tek një kënd lojërash në rrugën "Gjergj Fishta" dhe ofrimi i një hapësire argëtuese si një qendër komunitare për komunitetin lokal.

## Aktivitetet Kryesore

1. Organizimi i takimeve publike për përdorimin e parkut të gjelbër argëtues për fëmijët dhe të moshuarit.
2. Organizimi dhe mbikqyrja e punës ndërtimore për rikonstruksionin e këndit të lojërave.
3. Përgatitja e rregullore bashkiake për parqet dhe hapësirat publike në Mirditë. Organizimi i dëgjësive publike me banorët e zonave urbane të prekura nga rregulloret.
4. Organizimi i një udhëtimi studimor në Korçë me qëllim njohjen me rregulloret e menaxhimit të hapësirave publike.
5. Organizimi dhe inaugurimi i parkut për fëmijët dhe të moshuarit në rrugën "Gjergj Fishta", me pjesëmarrjen e gjerë të të gjithë përfituesve.




Funded by  
the European Union

**EU4MUNICIPALITIES**

6. Organizimi i 4 aktiviteteve të ndërgjegjësimit: një takim me temë “Fëmijët u mësojnë gjyshërve ndërkohë që gjyshërit u mësojnë fëmijëve”; një koncert me muzikë klasike nga orkestra “Wind” e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF); një ekspozitë punimesh: “Si e kuptojmë Europën?”; një projekt gjelbërimi “Lagjja ime e gjelbër”
7. Organizimi i aktivitetit përmbyllës.

## Rezultatet Kryesore


1. Një kënd lojërash i rindërtuar në rrugën “Gjergj Fishta”, një investim i cili përmirëson si aksesin, ashtu edhe cilësinë e shërbimeve argëtuese lokale për banorët e rinj të Rrëshenit.
2. 4 aktivitete publike me pjesëmarrjen e 1315 fëmijëve dhe 753 të moshuarve, organizuar në mjedisin e gjelbër të sapondërtuar, për të promovuar dialogun ndërbrezor, fuqizimin e të rinjve dhe të moshuarve, promovimin e kulturës së mjedisit të hapur, si dhe të vlerave të BE-së rreth jetesës së shëndetshme.
3. Rregullorja bashkiake e parqeve dhe hapësirave publike në Mirditë, është përgatitur dhe aprovuar nga Këshilli Bashkiak, si një udhëzues për përdorimin me efikasitet të hapësirave bashkiake publike.





## Rezultatet Kryesore

1. 649 fëmijë të informuar lidhur me mbrojtjen e mjedisit, të ndërgjegjësuar rreth jetesës së shëndetshme në harmoni me natyrën.
2. Një tarracë e gjelbër, e cila mund të përdoret si nga familjet që ndjekin shkollën “Kosova”, por edhe nga komuniteti.
3. Një tarracë e gjelbër e cila do sjellë së bashku fëmijët, prindërit e tyre si dhe mësuesit, gjatë aktiviteteve të mbjelljes dhe mirëmbajtjes së serës.





## Rezultatet Kryesore

1. Një zyrë informuese që ofron informacione rreth turizmit, në përputhje me standardet bashkëkohore për 5000 turistë në plazhin e Shëngjinit.
2. 10 anëtarë nga stafi i Bashkisë Lezhë, janë më të informuar dhe të aftësuar lidhur me mbështetjen e turizmit. Sektori i kulturës dhe komunikimit është i trajnuar me njohuritë e nevojshme, për të ofruar informacion turistik, bregdetar, kulturor, historik dhe gastronomik.
3. Bashkëpunim më i mirë ndërmjet Bashkisë Lezhë dhe bizneseve të turizmit, nëpërmjet organizimit të 2 (dy) takimeve me rreth 50 pjesëmarrës në secilin takim, me qëllim promovimin e shërbimeve bashkëkohore turistike, për një ofertë më të mirë turistike në Lezhë.



# Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimin e Çështjeve (NECRU) - shërbim për komunitetin

39



## MUNICIPALITY OF FUSHË-ARRËZ

### Informacion i Përgjithshëm

**Kohëzgjatja e Projektit: 9 muaj**  
**Buxheti i Përgjithshëm: 55,270 EUR**  
**Kontributi i BE-së: 49,250 EUR**  
**Kontributi Kombëtar: 6,020 EUR**  
**Komponenti i Investimeve: 32,000 EUR**

### Objektivi i Përgjithshëm

Shërbime bashkiake të përmirësuara në shërbim të grupeve të marginalizuara dhe vulnerabël në Bashkinë Fushë Arrëz.

### Objektivat Specifike

5 Njësi Administrative dhe Sektori i Shërbimeve Sociale në Bashkinë Fushë Arrëz, do të ofrojnë shërbime bashkiake të zhvilluara dhe funksionale, duke lehtësuar një qasje përfshirëse për kuotat gjinore dhe një dimension social për grupet e marginalizuara dhe vulnerabël në Bashkinë Fushë Arrëz.

## Aktivitetet Kryesore

1. Prezantimi i projektit me komunitetin e targetuar (grupet e marginalizuara dhe vulnerabël) në Fushë Arrëz.
2. Rikonstruksioni i qendrës multifunksionale, e cila do të ofrojë shërbime ndaj grupeve të marginalizuara dhe vulnerabël në Bashkinë Fushë Arrëz.
3. Krijimi i "Librit të Adresave" të qendrës multifunksionale NECRU si dhe i formularëve të dokumentacionit për pjesëmarrje të suksesshme të rasteve që lidhen me grupet e marginalizuara dhe vulnerabël.




Funded by  
the European Union

**EU4MUNICIPALITIES**

4. Organizimi i një trajnimit mbi lehtësimin e qasjes përfshirëse dhe dimensionin social të grupeve të marginalizuara dhe vulnerabël në Bashkinë Fushë Arrëz dhe përgatitja e metodologjisë për qëndrueshmërinë e këtyre shërbimeve.
5. Organizimi i digjitalizimit të shërbimeve.
6. Organizimi i dixhitalizimit të shërbimeve.
7. Organizimi i aktiviteteve të komunikimit dhe vizibilitetit

## Rezultatet Kryesore

1. Qendra multifunktionale e krijuar në Bashkinë Fushë Arrëz lehtëson një qasje gjithëpërfshirëse për kuotat gjinore dhe një dimension social për rreth 60 persona nga grupet e marginalizuara dhe vulnerabël:
  - 30 persona me aftësi të kufizuara (disabilities);
  - 10 persona me te ardhura të ulta ekonomike;
  - 20 persona me nevoja që përfshijnë katogrite: të rinj të marginalizuar, të moshuar, gra të abuzuara, individë të marginalizuar prej komunitetit romë etj.
2. Një punonjës social i punësuar në Bashkinë Fushë Arrëz, 5 persona nga Sektori i Kujdesit Social si dhe nga 1 person prej secilës njësi administrative, janë më të aftësuar për t'u shërbyer grupeve të marginalizuara dhe vulnerabël; shërbimi do të jetë i disponueshëm online.



Infrastrukturë më e mirë. Shërbime më të mira. Jetesë më e mirë.





Financuar nga  
Bashkimi Evropian

EU4MUNICIPALITIES

# EU4M NEWSLETTER

JUNE 2023

*Ky botim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e projektit EU4M dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet apo qëndrimet e Bashkimit Evropian.*



eu4municipalities.al

Kontakt:



info@eu4municipalities.al



facebook.com/EU4Municipalities



instagram.com/eu4municipalities.al



twitter.com/eu4\_m

Grupi i punës i botimit

Përgjegjës

Elton Stafa

Drejtues i Ekipit EU4M

Koordinatorë

Entela Pinguli

Zv. Drejtuese e Ekipit EU4M

Redaktore

Daniela Kostandini

Arti Grafik

Klesta Galanxhi

Durim Tabaku



Infrastrukturë më e mirë. Shërbime më të mira. Jetesë më e mirë.